



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 25 nëntor 2011, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Flora Brovina dhe Liburn Aliu.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Aurora Bakalli- deputete, Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahim- UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2012, lidhur me shëndetësinë;**
- 5. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2012, lidhur me Shëndetësinë

Fikrim Damka- Të gjithë jemi pajtuar se projektbuxheti për shëndetësi për vitin 2012 është i vogël. Krahësuar me rajonin, ne e kemi përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes së shëndetësisë në buxhet.

Ferid Agani- Deklaroi se ky buxhet i përgjigjet KASH-it. Për vitin 2012 parashihet një rritje prej 12 milionë euro, që shërben për inkorporimin e pagesës së shujtës në kuadër të pagës së rregullt për punëtorët shëndetësor, po ashtu një rritje vërehet te shpenzimet kapitale. Ky projektbuxhet, megjithë kërkesën tonë, nuk i ka marrë parasysh ligjet që do të miratohen së shpejti: Ligjin për shëndetësi dhe Ligjin për sigurime shëndetësore. Kemi bërë kërkesë për rritjen e tij në pozicionin mallra dhe shërbime. Shuma e paraparë për barëra është shumë e vogël, ku rreth 25% i shpenzojmë vetëm për citostatikë dhe sëmundje tjera të rralla. Ne kemi kursyer rreth 5 milionë euro me menaxhimin më të mirë të blerjes së barërave, edhe pse kemi blerë sasinë dhe llojin e njëjtë të barërave. Me këtë buxhet të ndarë, shëndetësia nuk është prioritet i Qeverisë. Shpresojmë që nga viti 2012, të kemi një gjendje më të mirë, kur kemi parasysh fillimin e funksionimit të Fondit për sigurime shëndetësore. Në memorandumun e Bankës Botërore, për herë të parë hyn edhe shëndetësia si objektiv i përbashkët. Kemi bashkëpunim të mirë me FMN-në dhe BB-në, por megjithatë ata kërkojnë shpjegime të qarta nga aspekti financiar, se si do të duket reforma e sistemit shëndetësor. Ne presim mbështetjen e Komisionit që t'i rekomandojë Komisionit për Buxhet dhe Financa, që kostoja e Ligjit të shëndetësisë dhe e Ligjit të sigurimeve, të përfshihen në buxhetin e vitit 2012 me një kosto rreth 7 milionë euro.

Aurora Bakalli- Po shihet që disa kërkesa në projektbuxhet, janë futur me kërkesë të Komisionit Evropian, siç është investimi në shëndetin e nënës dhe fëmijës me vlerë prej 100 mijë euro. Më intereson të di se çfarë mund të bëhet me një shumë të tillë? Viteve të tjera ka qenë si projekt, ndërtimi i spitalit të qytetit të Prishtinës, ndërsa sivjet nuk është.

Ferid Agani- Kjo shumë është e vogël, por kjo është krejt ajo që kemi mundur të bëjmë për momentin. Ne për këtë pozicion i kemi kërkuar 500 mijë euro dhe do të lidhemi edhe me programe humanitare që janë duke u zhvilluar në Kosovë. Ndërtimi i spitalit të qytetit të Prishtinës nuk ka qenë asnjëherë në ndonjë strategji, por ka ekzistuar vetëm në programet e partive politike. Prishtina nuk ka nevojë për spital të qytetit. Kosova ka nevojë për një qendër të re klinike të nivelit terciar.

Nazane Breca- Tha se regjistrimi i popullsisë nuk është në rregull dhe është politik, sepse Prishtina ka rreth 400-500 mijë banorë, të cilët kërkojnë shërbime në Prishtinë. Çka do të bëhet me ata persona që nuk janë regjistruar në Prishtinë, ndërsa kërkojnë shërbime mjekësore në ambulancat e qytetit?

Liburn Aliu- Jam i vetëdijshëm për buxhetin. Nuk ka ndonjë rritje cilësore. QKUK-ja ka zvogëlim të buxhetit krahasuar me vitin paraprak, ndërsa spitalet e tjera kanë rritje. Realizimi i projekteve në QKUK është mjaft i vogël, sipas raportit 9 mujor të shpenzimeve. Raporti i shpenzimeve i ka dy palë shifra. Investimet kapitale janë 7 milionë e 900 mijë euro, ndërsa të realizuara sipas raportit 9 mujor të shpenzimeve, janë vetëm rreth 41 % nga kjo shumë e paraparë për një pozicion të tillë. Ndërsa sipas raportit

më të detajuar për këto projekte, kemi si investime kapitale një vlerë prej 5 milionë e 929 mijë euro dhe konsiderohet se janë realizuar rreth 55% . Dua të di se, përse i kemi nga dy palë shifra?

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se sivjet, për dallim prej viteve të tjera, jemi mirë me shpenzimin e buxhetit. Në fundvit do të kemi një përqindje shumë të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe nuk do të ketë bartje për vitin tjetër, përkundrazi në disa pozicione kemi mungesë të mjeteve.

Bahri Thaçi- E pyeti ministrin: Çfarë mendon për raportin e investimeve kapitale kundrejt mallrave dhe shërbimeve? Nëpër disa komuna ka shumë mospërfillje ndaj shëndetësisë. Do të ishte mirë që edhe në nivelet komunale të regjistrohen nga Ministria objektet shëndetësore dhe gjendja e tyre.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur tha se, duhet të bëhet një shfrytëzim më i mirë i kapaciteteve në institucionet shëndetësore. Shfrytëzimi i tyre sillet rreth 60 %.

Aurora Bakalli- E pyeti ministrin: Sa planifikohet të investohet në degët deficitare, si mendoni ta rregulloni furnizimin me barëra?

Salihe Mustafa- Tha se, performanca e institucioneve shëndetësore është një gjë e mirë, por e cila më herët nuk ka funksionuar. Nuk kemi pasur mekanizëm që të stimulohen punëtorët në përputhje me rezultatet e punës të secilit.

Ferid Agani- Sistemi i ri shëndetësor do të ngris përgjegjësinë e punës dhe kualitetin e shërbimeve.

Time Kadriaj- Nga viti në vit nuk ka ndryshime në kategorinë mallra dhe shërbime. Nga kontaktet e mia me menaxherët e njësive të ndryshme, kam kuptuar se ata qysh në gjysmën e vitit, kanë probleme sa i takon këtij pozicioni. Ekziston rreziku, që pacientët të mbesin pa ushqim në institucionet shëndetësore, e po ashtu edhe pa shërbime të tjera. A keni marrë raport nga komisioni për shërimin e të sëmurëve jashtë vendit, sepse, siç e di unë, në disa raste po ndahen mjete për shërim jashtë vendit edhe për raste që mund të shërohen në Kosovë, a është ende valide marrëveshja që keni pasur me institucionet private të vendit për shërimin e pacientëve të cilët nuk mund të shërohen në institucionet publike?

Gëzim Kelmendi- E pyeti ministrin rreth donacionit të kampit amerikan Bondstill të disa objekteve montazhë, që mund të shfrytëzohen për shërbime specialistike në QKUK.

Flora Brovina- Tha se laboratorët nuk janë në gjendje të mirë. Sa i përket autoambulancave, ka mundësi të shfrytëzimit të lizingut si mundësi.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se për kardiokirurgji do të shpallen konkurse për specializim, e po ashtu objektin e kardiokirurgjisë e kemi rregulluar dhe për këtë do të shfrytëzojmë grande nga qeveria austriake, me qëllim të pajisjes së kësaj salle. Janë

planifikuar investime të mëdha në këtë degë dhe do ta themelojmë klinikën e kirurgjisë kardiovaskulare. Po ashtu, në të njëjtën formë do të përgatisim projektin edhe për ortopedi, duke blerë pajisje, material harxhues dhe gjithashtu edhe projektin për hematoonkologji. Sa i takon barërave, jemi duke e përmirësuar menaxhimin e shpërndarjes së tyre. Do të rrisim numrin e inspektorëve farmaceutik dhe shëndetësorë, e po ashtu do ta shkurtojmë listën esenciale. Nuk mund të ndodhë që të trajtohet jashtë vendit pacienti për të cilin ka shërim në institucionet e vendit. Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë do të jetë ndërmarrje publike jopropitabile, që do t'i ketë tri korporata.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka